

L I G J
Nr.9088, datë 26.6.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN DOGANORE MBI
IMPORTIMIN E PËRKOHSHËM TË AUTOMJETEVE RRUGORE PRIVATE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën doganore mbi importimin e përkohshëm të automjeteve rrugore private”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3894, datë 17.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTA
DOGANORE MBI IMPORTIMIN E PËRKOHSHËM TË AUTOMJETEVE RRUGORE PRIVATE

Gjenevë më 4 qershor 1954

Shënim: Teksti i riprodhuar më poshtë, përmban tekstin e plotë të Konventës doganore mbi importimin e përkohshëm të automjeteve rrugore private (1854) siç është amenduar më:

- a) 23 prill 1985, si rezultat i njoftimeve të depozituara C.N 162. 1984. Traktate-1 dhe C.N 14. 1985 Traktate-1;
- b) 30 tetor 1992, si rezultat i njoftimeve të depozituara C.N 315. 1991. Traktate-1 dhe C.N.228.1992 Traktate-1 dhe C.N.288.1992. Traktate-2;
- c) 5 nëntor 1995, si rezultat i njoftimeve të depozituara C.N.801. 1998. Traktate-1 C.N. 913. 1999 Traktate -1.

Palët Kontraktuese:

duke dëshiruar të lehtësojnë zhvillimin e udhëtimeve ndërkombëtare;

duke pasur parasysh qëllimet e Konventës mbi trafikun rrugor, adaptuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi transportin rrugor dhe automobilistik mbajtur në Gjenevë nga 23 gushti deri më 19 shtator 1949 dhe hapur për nënshkrim në Gjenevë më 19 shtator 1949;

kanë vendosur të konkludojnë një Konventë dhe kanë rënë dakord për parashikimet e mëposhtme:

KAPITULLI I PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllim të kësaj Konvente:

a) Termi “tatime të importit dhe taksa të importit” do të thotë tatime doganore dhe të gjitha tatimet, taksat, tarifat e tjera dhe pagesa të tjera, të cilat janë mbledhur nga, ose në lidhje me, importi i mallrave të përmendura në këtë Konventë, por duke mos përfshirë tarifa dhe pagesa të kufizuara në shumë deri në koston e përafërme të shërbimeve të kryera.

b) Termi “automjet” do të thotë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjitha mjetet motorike rrugore (përfshirë ciklet me motor) dhe rimorkiot (të importuara me automjetin ose veças), së bashku me pjesët e tyre përbërëse, aksesorët dhe pajisjet normale, kur importohen me automjetin.

c) Termi “përdorim privat” do të përjashtojë transportin e personave për pagesë, shpërblim ose kompensime të tjera dhe transportin industrial ose tregtar të mallrave me ose pa shpërblim.

d) Termi “dokumente të importimit të përkohshëm” do të përfshijë dokumentet doganore që tregojnë garancinë ose kaparin e tatimeve të importit dhe të taksave të importit.

e) Termi “persona” do të thotë persona fizikë dhe juridikë.

f) Termi “shoqëri emetuese” do të thotë një shoqëri e autorizuar për të lëshuar dokumentet e importimit të përkohshëm.

g) Termi “shoqëri garantuese” do të thotë një shoqëri e miratuar nga autoritetet doganore të një Pale Kontraktuese për të vepruar si garanci për personat që përdorin dokumentet e importimit të përkohshëm.

h) Termi “organizatë ndërkombëtare” do të thotë një organizatë tek e cila shoqëritë kombëtare janë pranuar si anëtare të cilat janë autorizuar të lëshojnë dhe të garantojnë dokumentet e importimit të përkohshëm.

i) Termi “Palë Kontraktuese” do të thotë një shtet ose një organizatë integrimi ekonomik rajonal, Palë në këtë Konventë.

j) Termi “organizatë integrimi ekonomik rajonal” do të thotë një organizatë e ngritur dhe e përbërë nga shtete të referuara në nenin 33 paragrafi 1 të kësaj Konvente, e cila ka kompetencë të adaptojë legjislacionin e saj që lidh shtetet anëtare të saj, në lidhje me çështjet e përcaktuara nga kjo Konventë dhe ka kompetencë të vendosë, në përputhje me procedurat e brendshme të saj, të hyjë në këtë Konventë.

KAPITULLI II IMPORTIMI PA PAGESËN E TATIMEVE TË IMPORTIT DHE TË TAKSAVE TË IMPORTIT DHE PA NDALIMET DHE KUFIZIMET E IMPORTIT

Neni 2

1. Secila nga Palët Kontraktuese do të lejojë hyrjen e përkohshme pa pagesën e tatimeve të importit dhe të taksave të importit dhe pa ndalimet dhe kufizimet e importit, që i nënshtrohet rieksporimit dhe kushteve të tjera të vendosura në këtë Konventë, të automjeteve në pronësi të personave normalisht rezidentë jashtë territorit të saj, të cilat janë importuar dhe janë përdorur, për përdorimin privat të tyre në rastin e një vizite të përkohshme ose nga pronarët e automjeteve, ose nga persona të tjerë normalisht rezidentë jashtë territorit të saj.

2. Palët Kontraktuese, sipas kushteve të vendosura në këtë Konventë, mund të urdhërojnë që automjete të tilla të mbulohen nga dokumentet e importimit të përkohshëm duke garantuar pagesën e tatimeve të importit dhe të taksave të importit ose një shumë ekuivalente që e kapin parashikimet e veçanta të nenit 27 paragrafi 4, me qëllim që automjetet e mbuluara nga dokumentet e importimit të përkohshëm të mos riimportohen brenda kohës limit të caktuar.

Neni 3

Karburanti, që ndodhet në serbatorin e zakonshëm të furnizimit të automjeteve të importuara përkohësisht, do të pranohet pa pagesën e tatimeve të importit dhe të taksave të importit dhe pa ndalimet dhe kufizimet e importit, duke u kuptuar se rezervuari i zakonshëm është ai i projektuar nga prodhuesi për tipin e automjetit të përfshirë.

Neni 4

1. Pjesët përbërëse të importuara për riparimin e një automjeti të veçantë, tashmë i importuar përkohësisht, do të pranohen përkohësisht pa pagesën e tatimeve të importit dhe të taksave të importit, dhe pa ndalimet dhe kufizimet e importit. Palët Kontraktuese mund të kërkojnë që këto pjesë të mbulohen nga dokumentet e importimit të përkohshëm.

2. Pjesët e këmbimit, të cilat nuk janë ricksportuar do t'u nënshtrohen tatimeve të importit dhe të taksave të importit, përveç, kur në përputhje me rregullat e vendit të përfshirë, ato mund t'i lihen falas thesarit ose të shkatërrohen nën mbikëqyrjen zyrtare, me shpenzimet e palëve të përfshira.

Neni 5

Dokumentet e importimit të përkohshëm dhe dokumentet e qarkullimit ndërkombëtar, që kanë për qëllim t'u lëshohen personave rezidentë në vendin në të cilin dokumentet importohen të cilët dëshirojnë të hyjnë në vende të tjera dhe të cilat u dërgohen shoqërive të autorizuar të udhëtimit nga shoqëritë e huaja korresponduese, nga organizatat ndërkombëtare ose nga autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese, do të pranohen pa pagesën e tatimeve të importit dhe të taksave të importit dhe pa ndalimet dhe kufizimet e importit.

KAPITULLI III

LËSHIMI I DOKUMENTEVE TË IMPORTIMIT TË PËRKOHSHËM

Neni 6

1. E varur nga garanci të tilla dhe sipas kushteve të tilla siç mund të përcaktohet, çdo Palë Kontraktuese mund të autorizojë shoqëri të tilla si ato të pranuar në një organizatë ndërkombëtare, të lëshojë ose direkt, ose me anë të shoqërive analoge, dokumentet e importimit të përkohshëm që mbulohen nga kjo Konventë.

2. Dokumentet e importimit të përkohshëm mund të jenë të vlefshme për një vend të vetëm ose territor doganor, ose për disa vende, ose territore doganore.

3. Periudha e vlefshmërisë së këtyre dokumenteve nuk do të kalojë një vit nga data e lëshimit.

Neni 7

1. Dokumentet e importimit të përkohshëm të vlefshme për territoret e të gjitha ose të disa Palëve Kontraktuese, do të njihen si "carnets de passages en douane" dhe do të jenë konform me formularin standard që gjendet në aneksin 1 të kësaj Konvente.

2. Nëse një "carnet de passages en douane" nuk është e vlefshme për një ose disa territore, shoqëria emetuese do ta tregojë këtë fakt në mbulesë dhe në kuponat e importimit të carnet.

3. Dokumentet e importimit të përkohshëm të vlefshme vetëm për territorin e një Pale Kontraktuese të vetme, mund të jenë konform formularit standard që gjendet në aneksin 2 të kësaj Konvente. Palët Kontraktuese, gjithashtu mund të përdorin dokumente të tjera, në përputhje me legjislacionin ose rregulloret e tyre.

4. Periudha e vlefshmërisë së dokumenteve të importimit të përkohshëm, përveç atyre të lëshuara nga shoqëritë e autorizuar siç jepet në nenin 6, do të vendoset nga secila Palë Kontraktuese në përputhje me legjislacionin ose rregulloret e saj.

5. Çdo Palë Kontraktuese do të furnizojë, sipas kërkesës, Palët e tjera Kontraktuese me formularë të dokumenteve të importimit të përkohshëm, të vlefshme për territorin e saj, përveç atyre të vendosura në anekset e kësaj Konvente.

KAPITULLI IV

HOLLËSI MBI DOKUMENTET E IMPORTIMIT TË PÛRKOHSHËM

Neni 8

Dokumentet e importimit të përkohshëm, të lëshuara nga shoqëritë e autorizuar, do të bëhen në emër të personave të cilët janë pronarë të automjeteve të importuara përkohësisht ose të atyre që i kanë në zotërim ose i kontrollojnë ato me kusht që, nëse automjeti është marrë me qira, dokumentet do të jenë në emër të qiramarrësit.

Neni 9

1. Pësha për t'u deklaruar në dokumentet e importimit të përkohshëm, është pëssha neto e automjeteve. Ajo duhet të shprehet në sistemin metrik. Në rastin e dokumenteve të vlefshme vetëm për një vend, autoritetet doganore të këtij vendi mund të caktojnë përdorimin e një sistemi tjetër.

2. Vlera për t'u deklaruar në dokumentet e importimit të përkohshëm të vlefshme vetëm për një vend, do të shprehet në monedhën e atij vendi. Vlera për t'u deklaruar në një "carnet de passages en douane" do të shprehet në monedhën e atij vendi ku carnet lëshohet.

3. Artikujt dhe çanta e veglave, të cilat formojnë pajisjet normale të automjeteve, nuk është e nevojshme të deklarohen posaçërisht në dokumentet e importimit të përkohshëm.

4. Kur autoritetet doganore e kërkojnë kështu pjesët (të tilla, si rrotat, gomat dhe tubat e brendshëm), si dhe aksesoret që nuk konsiderohen si pjesë përbërëse të pajisjeve normale të automjetit (si komplet radioje, rimorkio të padeklaruara në një dokument të veçantë, ose mbajtëse të bagazheve) do të deklarohen në dokumentet e importimit të përkohshëm me veçoritë e nevojshme (të tilla, si pëssha dhe vlera) dhe do të paraqiten në dalje nga vendi i vizituar.

Neni 10

Çdo veçori e futur në dokumentet e importimit të përkohshëm nga shoqëria emetuese mund të ndryshohet vetëm me miratimin e shoqërisë emetuese ose garantuese. Asnjë ndryshim në dokumente nuk mund të bëhet pasi ato kanë kaluar nga autoritetet doganore të vendit të importimit, përveçse me lejen e atyre autoriteteve.

Neni 11

1. Automjetet e pranuar sipas mbulimit të dokumenteve të importimit të përkohshëm mund të përdoren për përdorim privat të tyre, nga persona të tretë të autorizuar siç duhet nga mbajtësit e dokumenteve, me kusht që ata persona të tretë normalisht të banojnë jashtë vendit të importimit dhe gjithashtu të plotësojnë kushte të tjera të vendosura në këtë Konventë. Autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese kanë të drejtën të kërkojnë prova që persona të këtillë janë të autorizuar siç duhet nga mbajtësit e dokumenteve dhe plotësojnë kushtet e parathëna. Nëse këto prova nuk janë të mjaftueshme, autoritetet doganore mund të refuzojnë përdorimin e automjetit në territoret e tyre sipas mbulimit të dokumenteve. Në rastin e automjeteve, të cilat janë marrë me qira, çdo Palë Kontraktuese, në rast frike të abuzimit, mund të kërkojë që mbajtësi i dokumenteve të importit të përkohshëm të jetë i pranishëm në kohën e importimit të automjetit.

2. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit të mëparshëm, autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese mund të lejojnë, në rrethana të veçanta dhe sipas kushteve të të cilave ato do të jenë të vetmit gjyqtarë, një automjet që qarkullon sipas mbulimit të dokumenteve të importimit të përkohshëm të ngitet nga një person i cili normalisht është rezident në vendin e importimit, në veçanti kur shoferi nget automjetin në emër të ose sipas udhëzimeve nga mbajtësi i dokumenteve të importimit të përkohshëm.

KAPITULLI V KUSHTET E IMPORTIMIT TË PËRKOHSHËM

Neni 12

1. Automjetet e përmendura në dokumentet e importimit të përkohshëm do të rieksporthen në të njëjtën gjendje të përgjithshme përveç konsumimit, brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumenteve të tilla. Në rastin e automjeteve, të cilat janë marrë me qira, autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese do të kenë të drejtën të kërkojnë rieksportimin e automjetit, sapo qiramarrësi është larguar nga vendi i importimit të përkohshëm.

2. Prova e rieksportimit do të jepet nga viza dalëse bashkëngjitur si duhet në dokumentet e importimit të përkohshëm nga autoritetet doganore të vendit në të cilin automjetet u importuan përkohësisht.

Neni 13

1. Pavarësisht nga kërkesat e rieksportimit të vendosura në nenin 12, rieksportimi i automjeteve shumë të dëmtuara nuk do të kërkohej, në rastin e aksidenteve të vërtetuara siç duhet me kusht që automjetet:

a) t'u nënshtrohen tatimeve të importit dhe taksave të importit ndaj të cilave ato janë përgjegjëse;

b) t'i lihen falas thesarit të vendit në të cilin ato u importuan përkohësisht, në atë rast që mbajtësi i letrave të importimit të përkohshëm do të përjashtohet nga tatimet e importit dhe të taksave të importit;

c) të shkatërrohen, sipas mbikëqyrjes zyrtare, me shpenzimet e palëve të përfshira, ndonjë pjesë e mbetur dhe materiale duke iu nënshtuar tatimeve të importit dhe të taksave të importit për të cilat janë përgjegjëse siç mund ta kërkojnë autoritetet doganore.

2. Kur një automjet i pranuar përkohësisht nuk mund të rieksporthet si rezultat i një konfiskimi, përveç një konfiskimi të bërë me kërkesën e personave privatë, kërkesa e rieksportimit brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumenteve të importimit të përkohshëm do të pezullohet për vazhdimin e konfiskimit.

3. Autoritetet doganore do të njoftojnë, sa më shpejt të jetë e mundur, shoqërinë garantuuese për konfiskimet e bëra nga ose në emër të këtyre autoriteteve doganore e automjeteve të pranuar sipas mbulimit të dokumenteve të importimit të përkohshëm të garantuara nga ajo shoqëri dhe do ta njoftojnë atë për masat që ata propozojnë të marrin.

4. Kur automjeti ose objekti i listuar në dokumente, ose ka humbur ose është vjedhur gjatë kohës së konfiskimit, vetëm gjatë periudhës kur autoriteti publik posedon automjetin ose objektin përveçse një konfiskimi të bërë me kërkesë të personave privatë, asnjë tatim importi ose taksë importi, nuk mund të vihet përkundrejt mbajtësit të dokumenteve të importimit të përkohshëm, të cilët duhet të dorëzojnë prova të konfiskimit për shkak të depozitmbajtësit te autoritetet doganore.

Neni 14

Automjetet e importuara në territorin e njëres prej Palëve Kontraktuese nën mbulimin e dokumenteve të importimit të përkohshëm mund të mos përdoren as rastësisht për transport kundrejt pagesës, shpërblimeve ose kompensimeve të tjera midis pikave brenda kufijve të atij territori.

Neni 15

Personat që kanë të drejtën e shërbimeve të importimit të përkohshëm, gjatë periudhës së vlefshmërisë së dokumenteve të importimit të përkohshëm, mund të importojnë automjetet e mbuluara nga ato dokumente aq shpesh sa të jetë e nevojshme, me kusht që ato të kenë secilin kalim (hyrje dhe dalje) të vërtetuar me anë të një vize të zyrtarëve të doganës së përfshirë, nëse autoritetet doganore e kërkojnë kështu. Dokumentet e importimit të përkohshëm mund të bëhen të vlefshme vetëm për një udhëtim të vetëm.

Neni 16

Kur dokumentet e përkohshme të importimit pa kupona të veçantë për secilin kalim përdoren, vizat e dhëna nga zyrtarët e doganës midis hyrjes së parë dhe daljes së fundit janë të përkohshme. Megjithatë, kur viza e fundit është një vizë dalje e përkohshme, ajo do të pranohet si provë e rieksportimit të automjetit ose të pjesëve përbërëse të importuara përkohësisht.

Neni 17

Kur dokumentet e importimit të përkohshëm me një kupon të veçantë për secilin kalim përdoren, çdo hyrje nënkupton kalimin e dokumentit nga doganat dhe secila dalje në vijimësi përbën ekzekutimin e saj të fundit, përveçse siç parashikohet në nenin 18.

Neni 18

Kur autoritetet doganore të një vendi përfundimisht dhe në mënyrë të pakushtëzuar kanë ekzekutuar dokumentet e importimit të përkohshëm, ata nuk mund të kërkojnë më nga shoqëritë garantuese pagesën e tatimeve të importit dhe të taksave të importit, veçse nëse certifikata e ekzekutimit është përfituar në mënyrë jo të drejtë ose me mashtrime.

Neni 19

Vizat mbi dokumentet e importimit të përkohshëm të përdorura sipas kushteve të vendosura në këtë Konventë, nuk do t'i nënshtrohen pagesës së tarifave për shërbimin doganor gjatë orëve zyrtare për zyrat dhe postbllloqeve doganore.

KAPITULLI VI ZGJATJA E VLEFSHMËRISË DHE RINOVIMI I DOKUMENTEVE TË IMPORTIMIT TË PËRKOHSHËM

Neni 20

Mungesa e provave të rieksportimit brenda kohës së lejuar të automjeteve të importuara përkohësisht nuk do të merret parasysh, kur automjetet paraqiten tek autoritetet e doganave për rieksportim brenda katërmëdhjetë ditëve nga skadimi i afatit të fundit të hyrjes së përkohshme për automjetet dhe shpjegimet e mjaftueshme të vonësës jepen.

Neni 21

Çdo Palë Kontraktuese do të njohë si të vlefshme shtyrjet e vlefshmërisë së “carnet de passages en douane” të lëshuar nga një Palë tjetër Kontraktuese në përputhje me procedurën e vendosur në aneksin 3 të kësaj Konvente.

Neni 22

1. Kërkesat për shtyrjen e vlefshmërisë së dokumenteve të importimit të përkohshëm do t'u paraqiten autoriteteve doganore kompetente përpara skadimit të periudhës së vlefshmërisë të këtyre dokumenteve, veçse kur kjo bëhet e pamundur nga një forcë majeure. Nëse dokumentet e importimit të përkohshëm janë lëshuar nga një shoqëri e autorizuar, kërkesa për shtyrje do të bëhet nga shoqëria, e cila garanton dokumentet.

2. Shtyrjet e kohës së nevojshme për rieksportimin e automjeteve ose të pjesëve përbërëse të importuara përkohësisht do të jepen kur personat e përfshirë mund të vërtetojnë sipas pëlqimit të autoriteteve doganore që ato janë penguar nga një forcë majeure për rieksportimin e automjeteve të përmendura ose pjesëve përbërëse brenda kohës së lejuar.

3. Vlefshmëria e dokumenteve të importimit të përkohshëm, mund të shtyhet vetëm një herë për jo më tepër se një vit. Pas kësaj periudhe një carnet e re duhet të lëshohet dhe të jepet në këmbim të carnet të mëparshëm.

Neni 23

Çdo Palë Kontraktuese, veçse nëse kushtet e pranimi të përkohshëm nuk janë plotësuar më, do të autorizojë, me çfarëdoj mase kontrolli që ato mund ta konsiderojnë të nevojshme, rinovimin e dokumenteve të importimit të përkohshëm të lëshuara nga shoqëritë e autorizuar dhe që kanë lidhje me automjetet ose pjesët përbërëse të importuara përkohësisht në territorin e saj. Kërkesat për rinovim do të paraqiten nga shoqëria garantuese.

KAPITULLI VII RREGULLIMI I DOKUMENTEVE TË IMPORTIMIT TË PËRKOHSHËM

Neni 24

1. Nëse dokumentet e importimit të përkohshëm nuk janë ekzekutuar në mënyrë të rregullt, autoritetet doganore të vendit të importimit (nëse dokumentet kanë skaduar ose jo) do të pranojnë si provë të rieksporimit të automjetit ose të pjesëve përbërëse paraqitjen e një certifikate të bazuar në formularin standard të treguar në aneksin 4 të kësaj Konvente, të lëshuar nga një autoritet zyrtar (konsull, dogana, polici, kryetar bashkie, zyrtar juridik etj.) duke vërtetuar faktin se automjeti ose pjesët përbërëse në fjalë i janë paraqitur atij dhe janë jashtë vendit të importimit. Si një alternativë ata mund të pranojnë çdo provë tjetër të dokumentuar se automjeti ose pjesët përbërëse janë jashtë vendit të importimit të përkohshëm. Në rastin e dokumenteve, përveç “carnets de passages en douane”, të cilat nuk kanë skaduar, dokumentet do të bëhen në të njëjtën kohë me provën e referuar më sipër. Në rastin e carnets autoritetet doganore do të pranojnë, si provë të rieksporimit të automjeteve ose të pjesëve përbërëse, vizat e regjistruara më pas nga autoritetet doganore të vendeve të vizituara në vijim.

2. Në rastin e shkatërrimit, humbjes ose vjedhjes së një dokumenti të importimit të përkohshëm që nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt, por që ka lidhje me një automjet ose pjesët përbërëse të cilat janë rieksportuar, autoritetet doganore të vendit të importimit do të pranojnë si provë të rieksporimit paraqitjen e një certifikate të bazuar në formularin standard të treguar në aneksin 4 të kësaj Konvente, të lëshuar nga një autoritet zyrtar (konsull, dogana, polici, kryetar bashkie, zyrtar juridik etj.) duke vërtetuar faktin se automjeti ose pjesët përbërëse në fjalë i janë paraqitur atij dhe janë jashtë vendit të importimit pas datës së skadimit të dokumenteve. Si një alternativë ata do të pranojnë gjithashtu çdo provë tjetër të dokumentuar të vlefshme se automjeti ose pjesët përbërëse janë jashtë vendit të importimit të përkohshëm.

3. Në rastin e shkatërrimit, humbjes ose vjedhjes të një “carnet de passages en douane”, ndërsa automjeti ose pjesët përbërëse të cilit i referohet janë në territorin e njëres prej Palëve Kontraktuese, autoritetet doganore të asaj Pale, me kërkesë të shoqërisë së përfshirë, do të pranojnë një dokument zëvendësues, vlefshmëria e të cilit skadon në datën e skadimit të vlefshmërisë së carnet të cilën zëvendëson. Ky pranim do të anulohet pranimin e mëparshëm të carnet të shkatërruar, të humbur ose të vjedhur. Në rast të keqpërdorimit të një carnet pas anulimit nga autoritetet doganore dhe shoqërisë emetuese, kjo e fundit nuk do të mbahet përgjegjëse për tatimet e pagueshme të importit dhe të taksave të pagueshme të importit. Nëse, në vend të një dokumenti zëvendësues, një licencë eksporti ose një dokument i njëjtë lëshohet për rieksporimin e automjetit ose të pjesëve përbërëse, viza e daljes në këtë licencë ose dokument do të konsiderohet si provë e mjaftueshme e rieksporimit.

4. Nëse automjeti është vjedhur, pasi është rieksportuar nga vendi i importimit të përkohshëm, pa daljen që ka qenë vizuar në mënyrë të rregullt në dokumentet e importimit të përkohshëm dhe në mungesë të vizave hyrëse në dokumentet e regjistruara më pas nga autoritetet doganore të vendeve të vizituara në vijim, dokumentet megjithatë mund të rregullohen, me kusht që shoqëria garantuese t'i japë dokumentet së bashku me prova të tilla të vjedhjes sa mund të konsiderohet e mjaftueshme. Nëse dokumentet e importimit të përkohshëm nuk kanë skaduar, autoritetet doganore mund të kërkojnë dorëzimin e tyre.

Neni 25

Në rastet e referuara në nenin 24, autoritetet doganore do të kenë të drejtën të vendosin një tarifë rregullimi.

Neni 25 bis

Autoritetet doganore kompetente nuk duhet të kërkojnë pagesën e tatimeve të importit dhe taksa të importit kur provohet siç e duan ata se një automjet i importuar nën mbulimin e dokumenteve të importimit të përkohshëm nuk mund të rieksporthet më, sepse është shkatërruar ose ka humbur në mënyrë të paprapësueshme për arsye të një force majeure.

Neni 26

Autoritetet doganore nuk do të kenë të drejtë të kërkojnë nga shoqëria garantuese pagesën e tatimeve të importit dhe të taksave të importit për automjetet ose pjesëve përbërëse të importuara përkohësisht kur mosekzekutimi i dokumenteve të importimit të përkohshëm nuk i është bërë i ditur shoqërisë garantuese brenda një viti të datës së skadimit të vlefshmërisë së atyre dokumenteve. Autoritetet doganore duhet t'u japin shoqërive garantuese hollësi të shumës së tatimeve të importit dhe të taksave të importit brenda një viti nga data e njoftimit të mosekzekutimit. Shoqëritë garantuese do të pushojnë së qeni përgjegjëse për këto shuma nëse një informacion i tillë nuk u është dhënë brenda kësaj periudhe njëvjeçare.

Neni 27

1. Shoqëritë garantuese do të kenë një periudhë prej një viti nga data e njoftimit të mosekzekutimit të dokumenteve të importimit të përkohshëm në të cilin të japin prova të rieksportimit të automjeteve ose të pjesëve përbërëse në fjalë sipas kushteve të vendosura në këtë Konventë. Megjithatë kjo periudhë mund të hyjë në fuqi vetëm si për datën e skadimit të dokumenteve të importimit të përkohshëm. Nëse autoritetet doganore kontestojnë vlefshmërinë e provave të dhëna, ato duhet të informojnë për këtë garantuesin brenda një periudhe që nuk e kalon një vit.

2. Nëse një provë e tillë nuk jepet brenda kohës limit të lejuar, shoqëria garantuese do të depozitojë ose të paguajë përkohësisht brenda një periudhe maksimumi prej tre muajsh, tatimet e pagueshme të importit dhe taksat e pagueshme të importit. Kjo depozitë ose pagesë do të jetë përfundimtare pas një periudhe prej një viti nga data e depozitimit ose të pagesës së përkohshme. Gjatë periudhës së fundit, shoqëria garantuese akoma mund të përfitojë lehtësirat e dhëna nga paragrafi i mëparshëm, me qëllim që të marrë ripagimin e shumës së depozituar ose të paguar.

3. Për vendet, rregulloret e të cilave nuk parashikojnë depozitimin ose pagesën e përkohshme të tatimeve të importit, pagesat e bëra në përputhje me parashikimet e paragrafit të mëparshëm, do të konsiderohen si përfundimtare, duke u kuptuar se shumatat e paguara mund të kthehen, kur plotësohen kushtet e vendosura në këtë nen.

4. Në rast të mosekzekutimit të dokumenteve të importimit të përkohshëm, shoqërisë garantuese nuk do t'i kërkohet të paguajë një shumë më të madhe se totali i tatimeve të importit dhe të taksave të importit të aplikuara për automjetet ose pjesët përbërëse të parieksporthuara, së bashku me interesin nëse aplikohet.

Neni 28

Në rast mashtrimi, kundërvajtjeje ose abuzimi, Palët Kontraktuese, pavarësisht nga parashikimet e kësaj Konvente, do të jenë të lira të procedojnë kundër personave që përdorin dokumentet e importimit të përkohshëm, për rimbullimin e tatimeve të importit dhe të taksave të importit, dhe gjithashtu për vendosjen e një dënimi për të cilin këta persona e kanë bërë veten përgjegjës. Në raste të tilla, shoqëritë garantuese do t'u japin ndihmën e tyre autoriteteve doganore.

KAPITULLI VIII PARASHIKIME TË NDRYSHME

Neni 29

Palët Kontraktuese do të përpiqen të mos paraqesin procedura doganore, të cilat mund të kenë si efekt pengimin e zhvillimit të udhëtimit ndërkombëtar.

Neni 30

Me qëllim për të shpejtuar procedurat doganore Palët Kontraktuese fqinje do të përpiqen të vendosin postbolloqet doganore respektive të tyre afër njëra-tjetrës dhe t'i mbajnë ato të hapura në të njëjtën kohë.

Neni 31

Çdo thyerje e parashikimeve të kësaj Konvente, çdo zëvendësim, deklaram i rremë ose veprim që ka efekt t'i sjellë përfitim të padrejtë një personi ose një artikulli nga sistemi i importimit të vendosur në këtë Konventë, mund të bëjë shkelësin përgjegjës në vendin ku është kryer shkelja për gjobitje të caktuara nga ligje të atij vendi.

Neni 32

Asgjë në këtë Konventë nuk do të pengojë Palët Kontraktuese, të cilat formojnë një bashkim doganor ose ekonomik, nga nxjerrja e parashikimeve të veçanta të aplikueshme për rezidentët e shteteve që formojnë atë bashkim.

Neni 32 bis

Kjo Konventë nuk do të parandalojë aplikimin e lehtësirave më të mëdha të cilat Palët Kontraktuese japin ose që kanë dëshirë të japin, ose nga parashikime të njëanshme, ose për arsye të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, me kusht që lehtësira të tilla nuk pengojnë aplikimin e parashikimeve të kësaj Konvente. Palët Kontraktuese rekomandohen të shikojnë kërkesën e dokumenteve të importimit të përkohshëm dhe të garancive.

KAPITULLI IX PARASHIKIMET E FUNDIT

Neni 33

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1954 në emër të çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara dhe të çdo shteti tjetër të ftuar për të marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi formalitetet doganore për importimin e përkohshëm të mjeteve motorike rrugore private dhe për turizëm mbajtur në Nju Jork në maj dhe qershor 1954, këtej e tutje të referuara si Konferenca.

2. Kjo Konventë do t'i nënshtrohet ratifikimit dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 34

1. Nga 1 janari 1955 kjo Konventë do të jetë e hapur për pranim nga çdo shtet referuar në paragrafin 1 të nenit 3 dhe çdo shteti tjetër i ftuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara. Ajo gjithashtu do të jetë e hapur për pranim në emër të çdo territori nën kujdestari ku Kombet e Bashkuara janë autoriteti administrues i tij.

1bis. Çdo organizatë integrimi ekonomik rajonal mund të bëhet, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, një Palë Kontraktuese e kësaj Konvente. Një organizatë e tillë, e cila ka hyrë në këtë Konventë, do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për kompetencat e saj dhe të ndonjë ndryshimi këtu, në lidhje me çështjet e përcaktuara në këtë Konventë. Organizata dhe shtetet anëtare të saj, pa ndonjë shmangie nga detyrimet sipas kësaj Konvente, mund të vendosin mbi përgjegjësitë e tyre respektive për kryerjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Konvente.

2. Pranimi do të bëhet i vlefshëm nëpërmjet depozitimit të një instrumenti të pranimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 35

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit ose të pranimit pa ndonjë rezervë ose me rezerva të pranuar në përputhje me nenin 39.

2. Për çdo shtet ose organizatë integrimi ekonomik rajonal, ratifikues ose pranues i Konventës pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit ose të pranimit në përputhje me paragrafin e mëparshëm, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga një shtet i tillë ose organizatë integrimi ekonomik rajonal të instrumentit të tij të ratifikimit ose të pranimit, ose pa ndonjë rezervë ose me rezerva të pranuar në përputhje me nenin 39.

Neni 36

1. Pasi kjo Konventë ka qenë në fuqi për tre vjet, çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë atë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë muaj pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të njoftimit të denoncimit.

Neni 37

Kjo Konventë do të pushojë së qeni në fuqi nëse, për një periudhë prej dymbëdhjetë muajve me radhë pas hyrjes në fuqi, numri i Palëve Kontraktuese është më pak se tetë.

Neni 38

1. Çdo shtet në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose të pranimit, ose në çdo kohë pas kësaj, mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se kjo Konventë do të shtrihet tek të gjitha ose në ndonjë nga territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është përgjegjës. Konventa do të shtrihet në territoret e përmendura në njoftim, që nga dita e nëntëdhjetë pas marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm, nëse njoftimi nuk është i shoqëruar me një rezervë, ose nga dita e nëntëdhjetë pasi njoftimi ka hyrë në fuqi në përputhje me nenin 39, ose në datën në të cilën Konventa hyn në fuqi për shtetin e përfshirë, cilado është më e mëvonshme.

2. Çdo shtet, i cili ka bërë një deklaratë sipas paragrafit të mëparshëm, duke shtrirë këtë Konventë në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund ta denoncojë Konventën më vete në lidhje me atë territor në përputhje me parashikimet e nenit 36.

Neni 39

1. Rezervat ndaj kësaj Konvente të bëra para nënshkrimit të aktit final do të jenë të pranueshme, nëse ato janë pranuar nga një maxhorancë e anëtarëve të Konferencës dhe regjistruar në aktin final.

2. Rezervat e bëra pas nënshkrimit të aktit final nuk do të pranohen nëse mospëlqimi shprehet nga një të tretat e shteteve nënshkruese ose të Palëve Kontraktuese siç parashikohet më poshtë.

3. Teksti i çdo rezerve të dorëzuar tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara nga një shtet ose nga një organizatë integrimi ekonomik rajonal në kohën e nënshkrimit, depozitimi i një

instrumenti të ratifikimit ose të pranimit ose të çdo njoftimi sipas nenit 38 do të qarkullohet nga Sekretari i Përgjithshëm tek të gjitha Palët Kontraktuese, të cilat në atë kohë kanë nënshkruar, ratifikuar ose janë pranuar në Konventë. Nëse një e treta e këtyre Palëve Kontraktuese shpreh një mospëlqim, brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e qarkullimit, rezerva nuk do të pranohet. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese të referuara në këtë paragraf për çdo mospëlqim të marrë nga ai po ashtu të pranimit ose të kundërshtimit të rezervës.

4. Një mospëlqim nga një shtet i cili ka nënshkruar, por nuk ka ratifikuar Konventën, do të pushojë së pasuri ndikim nëse, brenda një periudhe prej nëntë muajve nga data e bërjes së mospëlqimit të tij, shteti i mospëlqimit nuk ka ratifikuar Konventën. Nëse, si rezultat i një mospëlqimi që ka pushuar së pasuri ndikim, një rezervë pranohet sipas zbatimit të paragrafit të mëparshëm, Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë Palët Kontraktuese të referuara në atë paragraf. Teksti i çdo rezerve nuk do të qarkullohet tek ndonjë shtet nënshkrues sipas paragrafit të mëparshëm, nëse ai shtet nuk ka ratifikuar Konventën brenda tre vjetëve pas datës së nënshkrimit në emër të tij.

5. Pala Kontraktuese që dorëzon rezervën, brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh nga data e njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm referuar në paragrafin 3 se një rezervë është kundërshtuar në përputhje me procedurën e parashikuar në atë paragraf, mund të tërheqë rezervën, në këtë rast instrumenti i ratifikimit ose i pranimit, ose njoftimi sipas nenit 38, si të jetë rasti, do të hyjë në fuqi në lidhje me këtë Palë Kontraktuese që nga data e tërheqjes. Gjatë një tërheqje të tillë, instrumenti ose njoftimi, si të jetë rasti, nuk do të ketë ndikim, veçse, sipas zbatimit të parashikimeve të paragrafit 4, rezerva është pranuar më pas.

6. Rezervat e pranura në përputhje me këtë nen, mund të tërhiqen në çdo kohë me anë të një njoftimi tek Sekretari i Përgjithshëm.

7. Asnjë Pale Kontraktuese nuk do t'i kërkohet t'i ofrojë një Pale Kontraktuese që jep një rezervë përfitimin e parashikimeve të cilave u aplikohet një rezervë e tillë. Çdo Palë Kontraktuese, që përfiton nga kjo e drejtë, do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm siç kërkohet dhe ky i fundit do t'ua komunikojë këtë vendim të gjitha shteteve nënshkruese dhe Palëve Kontraktuese.

Neni 40

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, do të zgjidhet deri tani si të jetë e mundur me anë të negociatave ndërmjet tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje që nuk zgjidhet me negociata, do të dorëzohet në arbitrazh, nëse njëra nga Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje e kërkon kështu dhe do t'i referohet siç kërkohet një ose më shumë gjyqtarëve të arbitrazhit të zgjedhur me marrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese në mosmarrëveshje. Nëse brenda tre muajve nga data e kërkesës për arbitrazh Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje nuk janë në gjendje të bien dakord në zgjedhjen e gjyqtarit ose gjyqtarëve të arbitrazhit, çdonjëra nga këto Palë Kontraktuese mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të emërojë një gjyqtar arbitrazhi të vetëm, të cilit do t'i kalohet mosmarrëveshja për vendim.

3. Vendimi i gjyqtarit ose gjyqtarëve të arbitrazhit, i caktuar sipas paragrafit të mëparshëm, do të jetë i detyrueshëm për Palët Kontraktuese të përfshira.

Neni 41

1. Pasi kjo Konventë ka qenë në fuqi për tre vjet, çdo Palë Kontraktuese me anë të një njoftimi tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, mund të kërkojë që një konferencë të mbledhet me qëllim që të rishikojë Konventën. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për kërkesën dhe një konferencë rishikimi do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm nëse, brenda një periudhe prej katër muajsh pas datës së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se gjysma e Palëve Kontraktuese e njofton atë se janë dakord me kërkesën.

2. Nëse Konferenca është mbledhur në përputhje me paragrafin e mëparshëm, Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese dhe t'i ftojë ato të dorëzojnë brenda një periudhe prej tre muajsh propozime të tilla që ata mund të dëshirojnë të merren në shqyrtim nga

Konferenca. Sekretari i Përgjithshëm do të qarkullojë tek të gjitha Palët Kontraktuese axhendën paraprake për Konferencën, së bashku me tekstet e propozimeve të tilla, të paktën tre muaj para datës në të cilën do të mbledhet Konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në çdo Konferencë të mbledhur në përputhje me këtë nen, të gjitha Palët Kontraktuese dhe të gjitha shtetet e tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara ose dhe agjenci të tjera të specializuara.

Neni 42

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente në këtë Konventë. Teksti i çdo amendamenti të propozuar do t'i transmetohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do ta qarkullojë atë tek të gjitha Palët Kontraktuese.

2. Çdo amendament i propozuar, i qarkulluar në përputhje me paragrafin e mëparshëm, do të gjykohet për t'u pranuar nëse asnjë Palë Kontraktuese nuk shpreh një mospëlqim brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas datës së qarkullimit të amendamentit të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Organizatat e Integritit Ekonomik Rajonal të cilat janë Palë Kontraktuese në këtë Konventë, për çështje brenda kompetencave të tyre, do të ushtrojnë të drejtën të shprehin një mospëlqim. Në një rast të tillë shteteve anëtare të organizatave të përmendura, të cilat janë Palë Kontraktuese në këtë Konventë, duhet t'u jepet e drejta për të ushtruar në mënyrë individuale të drejta të tilla.

3. Sekretari i Përgjithshëm do t'i njoftojë, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha Palët Kontraktuese, nëse është shprehur ndonjë mospëlqim për amendamentin e propozuar dhe nëse nuk është shprehur ndonjë mospëlqim, amendamenti do të hyjë me fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese tre muaj pas skadimit të periudhës prej gjashtë muajsh të referuar në paragrafin e mëparshëm.

Neni 43

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese dhe të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara për sa vijon:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet e marra në përputhje me nenin 33 dhe 34;
- a) bis.informacionin mbi kompetencat e organizatave të integritit ekonomik rajonal, si dhe çdo ndryshim në vijim të kësaj në përputhje me nenin 34, paragrafi 1 bis;
- b) datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 35;
- c) denoncimet e marra në përputhje me nenin 36;
- d) shfuqizimin e kësaj Konvente në përputhje me nenin 37;
- e) njoftimet e marra sipas nenit 38;
- f) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti në përputhje me nenin 42.

Neni 44

Originali i kësaj Konvente do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'u përcjellë kopje të vërtetuara të saj të gjitha Palëve Kontraktuese dhe të gjitha shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshminë e të nënshkruarit, duke qenë plotësisht i autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në New York, më 4 qershor 1954, në një kopje të vetme në gjuhët angleze, franceze dhe spanjolle, çdo tekst i barabartë autentikisht.

Sekretarit të Përgjithshëm i kërkohet të përgatisë një përkthim zyrtar të kësaj Konvente në gjuhët kineze dhe ruse dhe të shtojë tekstet në gjuhën kineze dhe ruse tek tekstet angleze, franceze dhe spanjolle, kur të përcjellë kopjet e vërtetuara të kësaj tek Palët në përputhje me nenin 44 të kësaj Konvente.

Informacioni vijues është dhënë nga shoqëria lëshuese për motoristët

ANEKS 1

“CARNET DE PASSAGE EN DOUANE”

Carnet është lëshuar në anglisht dhe në frëngjisht

Dimensionet janë 21x29.7 cm

Shoqëria lëshuese duhet të vendosë emrin e saj në secilën faturë dhe duhet të përfshijë inicialet e organizatës ndërkombëtare të cilës i përket.

Ky carnet, i cili është përgatitur në përputhje me dispozitat e Konventës së doganave për importimin e përkohshëm të mjeteve rrugore private (1954) dhe mjeteve rrugore tregtare (1956), mund të përdoret në vendet si më poshtë nën garancinë e shoqërisë së autorizuar të përcaktuar.

(LISTA E VENDEVE DHE SHOQËRIVE TË AUTORIZUARA)

ANEKS 2

TRIPTIK

Triptiku duhet të printohet në gjuhën kombëtare të vendit të importimit dhe, nëse është e dëshirueshme, edhe në ndonjë gjuhë tjetër

Dimensionet janë 13x29.5 cm

ANEKS 3

ZGJATJA E VLEFSHMËRISË SË “CARNET DE PASSAGES EN DOUANE”

1. Vula për zgjatjen e vlefshmërisë duhet të jetë konform me modelin e përfshirë në këtë aneks.

Vula duhet të përgatitet në anglisht ose në frëngjisht. Fjalët e shkruara mund të ripërsëriten në një gjuhë tjetër.

2. Procedura vijuese duhet të mbikë-qyret nga personi që kërkon zgjatjen dhe nga shoqëria garantuese që merret me këtë kërkesë:

a) Sapo mbajtësi i carnet de passages en douane shikon se është i detyruar të kërkojë një zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së dokumentit, ai i dërgon shoqërisë garantuese carnetin dhe një kërkesë për zgjatje, duke treguar rrethanat të cilat e detyrojnë atë të bëjë këtë kërkesë. Ai duhet të dorëzojë me kërkesën e tij si një evidencë mbështetëse, dokumente të tilla, si certifikatën mjekësore, një deklaratë nga një garazh që riparon mjetin e tij ose çdo dokument tjetër autentik, që tregon se vonesa në fjalë është shkaktuar nga një forcë madhore.

b) Nëse shoqëria garantuese e konsideron që kërkesa për zgjatje mund të kalojë tek autoritetet doganore, ajo vulos kapakun e carnet de passages en douane në hapësirën e rezervuar posaçërisht për këtë qëllim.

c) Në anën e majtë të vulës shoqëria garantuese plotëson datën me shifra dhe fjalë, deri në të cilën është kërkuar zgjatja. Presidenti ose përfaqësuesi i shoqërisë e firmos dhe i vihet vula e shoqërisë.

d) Gjatësia e zgjatjes nuk duhet të kalojë një periudhë të arsyeshme të nevojshme për të kryer udhëtimin dhe normalisht nuk duhet të kalojë tre muaj nga data e mëparshme e skadimit të carnetit.

e) Shoqëria garantuese pastaj dërgon carnetin tek autoritetet kompetente doganore të vendit të saj. Kërkesa e bërë nga mbajtësi i carnetit, si dhe evidencat mbështetëse i bashkëngjiten carnetit.

f) Autoritetet doganore vendosin nëse do të jepet zgjatja apo jo. Ato mund të shkurtojnë periudhën e zgjatjes së kërkuar ose mund të refuzojnë të japin një zgjatje. Nëse ajo jepet zyrtari i doganës përkatëse plotëson vulën e vendosur në kapakun e carnetit nga shoqëria garantuese, duke shtuar një numër serial ose regjistri, vendin dhe datën dhe pozicionin e tij zyrtar. Pastaj ai firmos dhe vendos vulën e doganës.

g) Carneti i rikthehet shoqërisë garantuese, e cila ia kthen personit përkatës.

Shoqëria
garantuese.....
Zgjatja e vlefshmërisë për të gjitha vendet ku ky
carnet është i vlefshëm, kërkohet deri
më.....
.....
.....
.....

.....me.....19

Nr.....
.....

Zgjatja e dhënë deri.....
më.....
.....
.....
.....
.....

.....me.....

..19.

Firma dhe pozicioni i
zyrtarit të doganës

ANEKS 4

MODELI I CERTIFIKATËS PËR RREGULLIMIN E SHKARKIMEVE, SHKATËRRIMEVE, HUMBJEVE OSE VJEDHJEVE TË DOKUMENTEVE TË IMPORTIMIT TË PËRKOHSHËM

(CERTIFIKATA E LOKALIZIMIT)

Emri i
vendit.....
Nënshkrimi i autoritetit.....
Dëshmon se këtë ditë.....(data të jepet e plotë)
Një mjet është paraqitur në.....(vendi dhe shteti)
Nga.....(emri dhe adresa)

Ky mjet në bazë të shqyrtimit, përshkruhet si më poshtë:

PËRSHKRIMI I MJETIT

Regjistruar në.....me numër.....
Viti i prodhimit.....
Pesha neto e mjetit
(kg).....
Vlera e mjetit.....
Numri i shasisë.....
Marka.....
Numri i motorit.....
Marka.....
Numri i cilindrave.....
Fuqia motorike.....
Karroceria.....
Tipi (veturë, kamion etj.).....
Ngjyra.....
Përshkrimi i brendshëm.....
Numri i vendeve të kapacitetit mbajtës...
Pajisje (radio
etj.).....
Pjesë këmbimi për
rrotat.....
Hollësi të tjera.....

A* Ky shqyrtim u bë gjatë
prezantimit të carnet de passages për
këtë makinë që përshkruhet këtu:

CPD-Nr.....

Lëshuar nga.....

B* Nuk janë paraqitur dokumente të
importimit të përkohshëm

Stampa

Data dhe vendi i firmosjes

Pozicioni zyrtar

Firma(t)

(*) Zgjidh formulën A ose B

N.B. Kjo certifikatë duhet të kompletohet ose nga një autoritet konsullor i vendit në të cilin dokumentet duhet të plotësohen ose nga një autoritet zyrtar (dogana, polici, bashki, zyrtar juridik etj.) i vendit në të cilin mjeti është kontrolluar.